REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8170/1 Prot.

Lushnje,më 18/09/2025

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. 86 DATË 18/09 2025**

**"PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I LUSHNJES" Z. GJERGJI VELO"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij te datës / /2025, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për dhenien e titullit "Qytetar Nderi i Lushnjes për z.Gjergji Velo",si dhe mbështetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, germa "m"; Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor te nderit ne Republikën e Shqipërise", Ligjit 94/2024 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit Këshilli Bashkiak, neni 11,pika 2;

**PROPOZOJMË:**

1. Të vlerësohet me titullin "Qytetar Nderi i Lushnjes" z.Gjergji Velo me motivacionin: *"Për vizionin e qartë dhe përkushtimin në transformimin e qytetit të Lushnjës si dhe rolin aktiv në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës".*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e QKKS.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**Drejtor e Burimeve Njerëzore**

**Erisa Qalliu**

**Drejtoria Juridike**

**Bedri Hida**

**KRYETAR I BASHKISË**

**Eriselda Sefa**

Adresa: Lagjja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8170 Prot. Lushnje,më 19/ 09/2025

**R E L A C I O N**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Këtu**

**"PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I LUSHNJES" Z. GJERGJI VELO"**

Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut Dega Lushnje kanë paraqitur ne Institucinin e Bashkisë Lushnje ,kërkesën për propozim për dhëniën e titulllit "Qytetar Nderi i Lushnjes" z.Gjergji Loni Velo.

Z.Gjergji Velo ka lindur në fshatin Eskaj, Bashkia Lushnje më 1 Qershor 1949. Ka kryer studimet e larta në Universitetin Bujqësor Tiranë, të cilin e ka mbaruar me nota maksimale nga Komisoni i Lartë Shtetëror, pasi u është nënshtruar provimeve shtetërore, ka fituar Gradën Shkencore "Doktor i Shkencave".

Ka punuar fillimisht Agronom në Bubullimë dhe në Janar 1973 emërohet në Institutin e Kërkimeve Bujqësore Lushnjë. Gjatë kësaj periudhe ka drejtuar mjaft mirë dhe ka arritur ta nxjerrë Lushnjën ndër rrethet e përparuara jo vetëm në rendimentet larta në drithërat e bukës e kulturat e tjera bujqesore por edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë.

Në vitet 1975 -1989 ka qënë drejtuesi kryesor i Pushtetit Ekzekutiv të Lushnjës (Kryetar).
Ka menaxhuar me sukses ecurinë frontale të të gjitha ekonomive bujqësore të ish-rrethit të Lushnjës duke e ngritur Lushnjen në një kategori me rrethet e mëdha të Republikës.
Ka qënë në krye të disa reformave ekonomike e sociale, së bashku me inteligjencën drejtuese të Lushnjës.Gjatë kësaj periudhe u rrit ndjeshëm numri i pallateve për strehimin e popullsisë, u përmirësuan kushtet e mjediseve të institucioneve arsimore,të kulturës e të shëndetësisë.

Adresa: Lagjja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Më 1989-1991, zotit Gjergji i besohen detyra si drejtues kryesor i ish-Rrethit të Tepelenës e më pas si supervizor kryesor i Qeverisë Shqiptare, Këshilltar në Ministrinë e Mjedisit dhe në vitin 2011 Kryetar i Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut detyrë që e mban aktualisht.

Z. Gjergji Velo ka marre disa vlerësime:
-Urdhër për Shërbime të Shquara Shtetërore e Shoqërore Kl.Pare
-Mirënjohja e Qarkut të Tiranës,
-Nderi i Bashkisë Tiranë,
-Nderi i Shkollës së Mesme "Koli Allkanjari" Këmishjtaj,
-Ambasador i Paqes.

Nisur nga kontributi i tij për Lushnjen propozoj Dhënien e Titullit "Qytetar Nderi i Lushnjes" për z.Gjergji Velo.

*Ju faleminderit!*

**KRYETAR I BASHKISË**

**Eriselda Sefa**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com